

## Porti i Durrësit

### OPEN PORT 2011 – 24 & 25 qershor

---

36 orë festë me veprimtari kulturore për të gjitha moshat në hapësirat e portit më të madh të vendit. Porti detar i Durrësit do të jetë në dispozicion të qytetarëve dhe pushuesve më 24-25 qershor të këtij viti.

Veprimtaria kulturore shumëplanëshe Open Port vjen në në edicionin e dytë të saj me një itinerar më të plotë, që synon të kthejë në protagonistë të gjitha grupmoshat pjesëmarrëse në Festën e madhe.

Dyert e portit do të jenë të hapura për të gjithë për 36 orë radhazi, duke filluar nga mbrëmja e së premtes më 24 qershor. *Week end* i fundit i muajit qershor është përzgjedhur si koha më e përshtatshme për të afruar në mjediset portuale fëmijët dhe të rinjtë, të cilët përfundojnë ciklin shkollor 2010-2011.

Dy superkoncerte për të gjitha moshat do të vazhdojnë deri në mesnatë dhe mysafirët do të festojnë së bashku me artistë të njohur si Vëllezërit korçarë, Juluana Pasha, Maja, Ylli Baka, Eranda Libohova, Vedat Ademi, Çiljeta Xhilaga e Gent Bushpepa.

Në një zonë të veçantë nxënësit e vegjël do të gjejnë surpriza të shumta, mjaft të këndshme për moshat e tyre. Të mirëpritur do të jenë edhe ata që preferojnë t'i ndjekin me patinat apo biçikletat personale të gjitha stacionet e festës, të cilat nuk do të jenë të pakta.

Në kalatën 4 e 5 do të ankorohen disa nga mjetet lundruese që kanë lidhur historikun e tyre me portin detar, ndërsa bashkë me to do të jenë të hapura për publikun edhe sallat e Kapitenerisë së portit si dhe mjediset e punës së Forcës së Sigurisë portuale.

Ekspozita fotografike kushtuar qytetit bregdetar të Durrësit, përgatitur nga fotografi Gëzim Domi do të jetë një stacion tjetër kulturor në itinerarin e open Port 2011.

Mysafirë të Festës do të jenë Ansamblet e fëmijëve artistë të QKF, si dhe ansambli popullor “Durrësi” koncertet e të cilëve bashkë me perlat e këngës dhe valles qytetare do të sjellin mjaft aromë deti.

Personeli i APD do të jetë në dispozicion të festës dhe pjesmarrësve të saj.

